


**RAPORTI I  
HULUMTIMIT  
TË OPINIONIT**

# LIDHUR ME QËNDRIMET DHE SJELLJET E VOTUESVE TË RINJ

SHKURT 2017



ZGJEDHJET E LIRA  
DHE TË DREJTA






**RAPORTI I  
HULUMTIMIT  
TË OPINIONIT**

# **LIDHUR ME QËNDRIMET DHE SJELLJET E VOTUESVE TË RINJ**

**SHKURT 2017**



COPYRIGHT © 2018. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Autor: **Eugen Cakolli**

Kontribuan në raport: **Ahmet Rushiti & Albert Krasniqi**

Layout and design: **Envinion**

**Vërejtje:** Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit "Fuqizimi i votuesve të rinj për të marrë vendime duke qenë të informuar, dhe duke i ndihmuar ata që t'i mbajnë politikanët llogaridhënës", i mbështetur nga Ambasada Britanike në Prishtinë. Përbajtja dhe të dhënat e prezantuara në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

## 02 Përmbledhje ekzekutive

- 02 A. Qëllimi dhe metodologjia e hulumtimit
- 02 B. Të gjeturat kryesore të hulumtimit

## 04 2. Vendimmarrja dhe mjetet e informimit në mesin e të rinjve

- 04 A. Ndikimi i familjes dhe shoqërisë
- 05 B. Mjetet nga të cilat informohen të rinjtë
- 06 C. Faktorët që ndikojnë në përcaktimin e votuesve
- 07 D. Roli i bashkësisë ndërkombëtare në përcaktimin e votuesve

## 08 3. Bindjet e votuesve të rinj për qeverisjen e vendit

- 08 A. Shqetësimet e të rinjve të Kosovës
- 10 B. Besimi në institucione
- 11 C. Niveli i kënaqshmërisë me punën e qeverisë

## 12 4. Besimi i votuesve të rinj në procesin zgjedhor

- 12 A. Pjesëmarrja në zgjedhje
- 14 B. Motivet për të votuar
- 15 C. Motivet për të mos votuar
- 16 D. Përmirësimi i procesit zgjedhor

## 17 4. Subjektet politike dhe kandidatët më popullor në mesin e votuesve të rinj

- 17 A. Subjektet politike më të preferuara
- 19 B. 'Lojaliteti' ndaj subjektit politik
- 19 C. Politikanët model për të rinjtë





Nga të rinjtë është kërkuar që të japin emrin e politikanit model për ta. Nga 69 emra të ndryshëm që janë dhënë, Albin Kurti është politikanit model për 13.7 për qind e të rinjve, i pasuar nga Hashim Thaçi (10.5 për qind) dhe Kadri Veseli (7.5 për qind).


23.5 për qind e të intervistuarve kanë deklaruar se asnjë prej politikanëve ekzistues nuk janë model që duhet ndjekur, kurse interesimi për të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhme parlamentare është treguar i lartë (76.1 për qind janë shprehur të interesuar për të votuar).

Programi politik, lista e kandidatëve dhe historiku i subjektit politik janë identifikuar si faktorët përcaktues në përzgjedhjen e subjektit politik. Në këtë drejtim, të rinjtë ndërmjet moshës 17 dhe 21 vjeçare kanë deklaruar se nëse zgjedhjet e ardhshme parlamentare do të mbaheshin nesër, do të votonin për këto subjekte politike: Lëvizja VETËVENDOSJE! 27 për qind; Partia Demokratike e Kosovës (20 për qind); Lidhja Demokratike e Kosovës (13 për qind); Aleanca Kosova e Re (7 për qind); Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (7 për qind), Nisma për Kosovën (3 për qind) si dhe Lista Serbe (3 për qind).

Një numër i madh i të intervistuarve prej 18 për qind kanë refuzuar të përgjigjen në pyetjen se për cilin subjekt politik do të votonin në zgjedhjet e ardhshme.

# 23.5%

e të intervistuarve kanë deklaruar se asnjë prej politikanëve ekzistues nuk janë model që duhet ndjekur, kurse interesimi për të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhme parlamentare është treguar i lartë (76.1 për qind janë shprehur të interesuar për të votuar).





# 2. VENDIMMARRJA DHE MJETET E INFORMIMIT NË MESIN E TË RINJVE

## A. Ndikimi i familjes dhe shoqërisë

Pjesëmarrja e të rinjve në procesin e vendimmarrjes është një ndër elementet kyçe për zhvillimin e tyre. Vendimmarrja e të rinjve është e varur nga shumë faktorë, ndër të cilët, familja dhe shoqëria luajnë një rol të konsiderueshëm. Sidoqoftë, në aspektin politik, përkundër faktit që shumica e të rinjve kanë deklaruar që është e zakonshme të diskutohet për politikën në familjet e tyre, pjesa dërrmuese e tyre (66.8 për qind) kanë

thënë se secili anëtar merr vendim të pavarur nga ndikimi familjar për votën e tij/saj. Vetëm për 4.4 për qind e të intervistuarve, familja përbën faktorin përcaktues se për kë do të votojnë të rinjtë në zgjedhjet e ardhshme. Vlen të ceket që të rinjtë kanë tendencë të diskutojnë lidhur për politikën më shumë me familjarët e tyre sesa me shoqërinë.

Ndikimi i familjes dhe shoqërisë vërehet më shumë sa i përket vendimeve tjera në jetë, për të cilat 60.5 për qind e të rinjve konsultohen me familjen apo shoqërinë.

# 4.4%

e të intervistuarve, familja përbën faktorin përcaktues se për kë do të votojnë të rinjtë në zgjedhjet e ardhshme.








## B. Mjetet nga të cilat informohen të rinjtë

Televizionet dhe rrjetet sociale janë burimet kryesore të informimit të të rinjve lidhur me politikën dhe platformat e subjekteve politike. Pothuajse shumica e të intervistuarve (45.3 për qind) shohin televizionin si mjet kryesor të informimit për platformat e subjekteve politike. Një pjesë tjetër e konsider-

ueshme e të intervistuarve (31.7 për qind) kanë rrjetet sociale si burim kryesor të informimit. Ndër mjetet tjera të evidencuara nga të rinjtë janë radiot, gazetatat, por edhe bisedat me shokë/shoqe apo familjarë.

Ueb-faqet e subjekteve politike janë burimi prej ku të rinjtë informohen **më së paku** për platformat e subjekteve politike. Kjo, kryesisht si rezultat i mungesës së ueb-faqeve funksionale të shumicës së subjekteve politike.

### Mjetet nga të cilat informohen të rinjtë lidhur me politikën





## C. Faktorët që ndikojnë në përcaktimin e votuesve


Në pyetjen se cilët janë faktorët që të rinjtë marrin parasysh kur përcaktohen se për subjekt politik që do t'a votojnë në zgjedhjet e ardhshme, rreth 34 për qind e të intervistuarve kanë cilësuar **programin politik** si faktorin kyç përcaktues. Kandidatët, qofshin për deputetë, kryetarë komunash apo anëtarë të kuvendeve komunale, janë po ashtu faktor determinues, për 23 për qind e të intervistuarve.

Ndër faktorët tjerë të ndërlidhur me subjektet politike, e që ndikojnë në përcaktimin e votuesve janë historiku i subjektit (15.5 për qind) dhe lideri i subjektit në fjalë (13.9 për qind).

Përkrahja e miqve (5.7 për qind), ndikimi familjar (4.4 për qind) dhe përfitimet personale (3.2 për qind) janë faktorët me më së paku ndikimin në përcaktimin e votuesve.

Ndërsa, në lidhje me atributet që kanë rol përcaktues në lidhje me kandidatin që do votojnë të rinjtë në zgjedhjet e ardhshme, niveli i edukimit (73.6 për qind) dhe përvoja në politikë (59.6 për qind) janë ndjeshëm faktor më determinues në krahasim me faktorët apo atributet tjera si mbrojtja e kategorive të marginalizuara (31.4 për qind), qëndrimet e njëjta për politika specifike (22.3 për qind), përkatësia partiake (21.5 për qind), afërsia me kandidatin (16.7 për qind), paraqitja e mirë në debate televizive (16.1 për qind) dhe praktikimi i fesë nga kandidati (13.8 për qind).

### Faktorët që ndikojnë në përcaktimin e votuesve të rinj:





## D. Roli i bashkësisë ndërkombëtare në përcaktimin e votuesve

Procesi i shtetndërtimit të Kosovës ka qenë i lidhur me faktorin ndërkombëtar. Si rrjedhojë, edhe në aspektin elektoral, roli i faktorit ndërkombëtar është i patjetërsueshëm. Në bazë të këtij hulumtimi, një e gjetur mjaft interesante është se 61 për qind e të intervistuarve nuk janë të kënaqur me rolin e bashkësisë ndërkombëtare në procesin vendimmarrës. Prej tyre, 38.4 për qind shohin rol të tepruar, kurse 22.6 për qind një rol më të zbehur të faktorit ndërkombëtar. Në anën tjetër, 39 për qind e të intervistuarve janë të bindur se bashkësia ndërkombëtare ndikon aq sa duhet në proceset vendimmarrëse në Kosovë.


Faktori ndërkombëtar konsiderohet element relativisht përcaktues edhe sa i përket mënyrës se si votojnë të rinjtë, pasi që shumica dërmuese e të intervistuarve e vlerësojnë rëndësinë e përkrahjes nga bashkësia ndërkombëtare për një subjekt politik si determinuese në përcaktimin e tyre se kë do të votojnë.

Roli i bashkësisë ndërkombëtare është mjaft i theksuar edhe kur është në pyetje integriteti i procesit zgjedhor, duke qenë se shumica e të intervistuarve janë të kënaqur me rolin e bashkësisë ndërkombëtare në zgjedhjet e fundit në Kosovë. Madje, sipas hulumtimit, del se besueshmëria në integritetin e procesit zgjedhor do të cenohet pa përfshirjen e vëzhguesve ndërkombëtar, sepse pa ta zgjedhjet nuk do të ishin transparente sa duhet.

Në bazë të këtij hulumtimi, një e gjetur mjaft interesante është se

# 61%

e të intervistuarve nuk janë të kënaqur me rolin e bashkësisë ndërkombëtare në procesin vendimmarrës.





# 3. BINDJET E VOTUESVE TË RINJ PËR QEVERISJEN E VENDIT

## A. Shqetësimet e të rinjve të Kosovës


Në funksion të përmirësimit të situatës për të rinjtë, të intervistuarit janë pyetur në lidhje me shqetësimet kryesore që mund të kenë, e të cilat duhet të adresohen nga Qeveria. Të rinjtë kanë listuar shqetësimet kryesore të tyre, ndër të cilat, temat si Demarkacioni i Kufirit me Malin e Zi, Asociacioni i Komunave me shumicë serbe apo ekstremizmi fetar, që u servohen të rinjve në media në baza ditore, nuk janë listuar si shqetësime kryesore të të rinjve. Pesë preokupimet kryesore të të rinjve janë papunësia (65.1 për qind), zhvillimi ekonomik (54.6 për qind), luftimi i korrupsionit (51.3 për qind), shëndetësia (42.2 për qind) dhe liberalizimi i vizave (41.1 për qind). Kjo renditje është e ngjashme edhe në bazë të ndarjes në baza etnike të të intervistuarve.

Ndër shqetësimet tjera, të cilat janë listuar nga të rinjtë e intervistuar janë arsimi (36 për qind), sundimi i ligjit (28.9 për qind), kultura, rinia dhe sporti (27.5 për qind), Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi (21.6 për qind), mungesa e investimeve të huaja në Kosovë (19.5 për qind), transformimi i FSK-së në ushtri (16.9 për qind), mbrojtja e mjedisit (16.4 për qind), integrimi në Bashkimin Evropian (16.1 për qind), migrimi (12.1 për qind), ekstremizmi fetar (11.4 për qind), infrastruktura (10.8 për qind), Asociacioni i Komunave me shumicë serbe (10.6 për qind), subvencionimi i bujqësisë (9.9 për qind) dhe pjesëmarrja e qytetarëve të Kosovës në luftërat e huaja (8.2 për qind). Renditja e këtyre shqetësimeve është pothuajse e njëjtë bazuar edhe në ndarjen e të intervistuarve në bazë të përkatësisë së tyre etnike.





## Shqetësimet e të rinjve të Kosovës





## B. Besimi në institucione

Sipas rezultateve të këtij hulumtimi, del se institucioni të cilin të rinjtë i besojnë më së shumti është pushteti komunal, kurse Qeveria e Kosovës është institucioni që gëzon më së paku besim. Partitë politike ndodhen në vendin e fundit për nga niveli i besimit nga të rinjtë. Institucionet tjera kyçe shtetërore si Presidenca, Kuvendi i Kosovës, Gjykatat dhe Prokuroritë bëjnë pjesë në listën e institucioneve relativisht të besueshme prej të rinjve.


Bazuar në nivelin e besueshmërisë së secilit institucion, Presidenca gëzon nivelin më të lartë të besimit nga të rinjtë të cilët kanë deklaruar që nuk realizojnë fare të ardhura gjatë muajit, kurse niveli më i ulët të besimit ndaj institucionit të Presidencës është tek të rinjtë që gjenerojnë të ardhura mujore familjare mbi 1,200 euro. Edhe Qeveria e Kosovës gëzon nivelin më të lartë të besimit tek po i njëjti grup, ndërsa nivelin më të ulët të besimit e ka tek komuniteti serb. Kuvendit të Kosovës del se më së shumti i besojnë të rinjtë të cilët kanë

të ardhura mujore familjare prej 0 deri në 150 euro, kurse më së paku i besojnë të rinjtë e komunitetit serb. Komuna, që ka dalë të jetë në përgjithësi institucioni më i besuar, ka më së shumti besimin e të rinjve, familjet e të cilëve gjenerojnë të ardhura mujore familjare mbi 1,200 euro, kurse më së paku kanë besimin, sërish të të intervistuarve nga komuniteti serb. Gjykatat dhe prokuroritë janë vlerësuar si më të besuarat nga të rinjtë që kanë të ardhura mujore familjare mbi 1,200 euro, kurse të rinjtë nga komuniteti serb janë më mosbesuesit ndaj tyre. Partitë politike, që në përgjithësi janë subjekti me më së paku besim, kanë më së shumti besimin e të rinjve që kanë të ardhura mujore familjare deri në 150 euro, kurse nivelin më të ulët të besimit e kanë, nga të rinjtë e komunitetit serb, dhe të rinjtë që kanë përfunduar së paku studimet (fakultetin).

Sipas këtyre të dhënave, del se grupi që ka më së shumti besim ndaj institucioneve të Kosovës janë të rinjtë të cilët kanë të ardhura mujore familjare mbi 1,200 euro, kurse grupi më mosbesues janë të intervistuarit nga **komuniteti serb** dhe të rinjtë që nuk gjenerojnë **mjaftueshëm të ardhura mujore**.

### Niveli i besimit në institucione

[Ku 1=Aspak dhe 5=Plotësisht]





## C. Niveli i kënaqshmërisë me punën e qeverisë

Përveç se është institucioni më së paku i besuar, Qeveria kritikohet edhe për performancën e saj të punës. Puna e Qeverisë vlerësohet si e dobët dhe joefikase nga 75 për qind e të intervistuarve. Pjesa tjetër e të intervistuarve (25 për qind), vlerëson se Qeveria shpesh kritikohet padrejtësisht, përkundër punës së mirë që bën. Përgjashtim nga ky qëndrim bëjnë të rinjtë nga komuniteti serb, të cilët janë më të kënaqur me punën e Qeverisë, konkretisht në masë prej pothuajse 40 për qind, për dallim nga komuniteti shqiptar dhe komunitetet tjera, që mbesin në shifrën prej 25 për qind sa i përket përkrahjes së punës së Qeverisë.

Interesant është fakti se gati gjysma e të rinjve (41.2 për qind), familjet e të cilëve gjenerojnë nivel të lartë të të ardhurave mujore (901-1200€), kanë vlerësim pozitiv për punën e Qeverisë. Më të pakënaqurit me punën e Qeverisë janë të rinjtë, familjet e të cilëve gjenerojnë të ardhura minimale gjatë muajit (0-150€). 91.3 për qind e këtyre të rinjve e shohin punën e Qeverisë si të dobët dhe joefikase.

Vetëm një pjesë e vogël e të rinjve, përkatësisht 25 për qind të intervistuarve, kanë vlerësuar se qeveria punon në interes të të gjithë qytetarëve. Kurse, pjesa tjetër (75 për qind), e vlerësojnë qeverinë si **përfaqësues të interesave të një grupi të vogël të individëve**.



Vetëm një pjesë e vogël e të rinjve, përkatësisht 25 për qind të intervistuarve, kanë vlerësuar se qeveria punon në interes të të gjithë qytetarëve. Kurse, pjesa tjetër (75 për qind), e vlerësojnë qeverinë si përfaqësues të interesave të një grupi të vogël të individëve.






# 4. BESIMI I VOTUESVE TË RINJ NË PROCESIN ZGJEDHOR

## A. Pjesëmarrja në zgjedhje

Pjesëmarrja në zgjedhje paraqet numrin e votuesve që kanë marrë pjesë në zgjedhje, në raport me numrin e personave në listën përfundimtare të votuesve. Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014 kanë marrë pjesë 42.63 për qind e votuesve me të

drejtë vote. Ndërsa, në zgjedhjet lokale dhe ato për kryetarë të komunave kanë marrë pjesë 46.31 për qind, respektivisht 46.34 për qind e votuesve me të drejtë vote. Në bazë të këtyre të dhënave, mund të konkludohet se ka një trend më të lartë të pjesëmarrjes në zgjedhjet e nivelit lokal, në krahasim me nivelin qendror.

### Pjesëmarrja e votuesve të rinj në zgjedhjet parlamentare (2014)








Nga përgjigjet e të intervistuarve në këtë hulumtim, del se vetëm 22.6 për qind e tyre votuar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Duke qenë se ky hulumtim ka përfshirë të rinjtë e moshave 17 deri 21 vjeç, një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve nuk kanë pasur të drejtë vote në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014, për shkak të moshës apo arsyeve tjera. Kurse, nga të intervistuarit që kanë pasur të drejtë vote, 77.4 për qind e tyre kanë ushtruar të drejtën e tyre të votës.

Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014, ka pasur një interesim relativisht më të lartë të votuesve **djem** për të ushtruar të drejtën e votës, në raport me votueset vajza, duke qenë se votuesit djem (24.3 për qind) kanë votuar për rreth 4 pikë përqindje më shumë sesa votueset femra (20.1 për qind).

Sipas ndarjes në baza etnike të respondentëve, të dhënat tregojnë një pjesëmarrje në zgjedhje pak më të lartë në përqindje të komunitet serb (36 për qind), krahasuar me komunitetin shqiptar (31.2 për qind) dhe komunitetet tjera jo-shumicë (27 për qind).

Të ardhurat mujore familjare po ashtu, paraqesin një faktor mjaft të rëndësishëm për nivelin e pjesëmarrjes në zgjedhje. Sipas të gjeturave të këtij hulumtimi, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhje e kanë të rinjtë të cilët në familjet e tyre kanë të ardhura mujore mbi 1,200 euro. 40 për qind e kësaj kategorie kanë deklaruar që kanë votuar në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014. Kurse, përqindjen më të ulët të pjesëmarrjes në zgjedhje e kanë të intervistuarit të cilët kanë deklaruar që në familjet e tyre kanë të ardhura mujore prej 0 deri në 150 euro. Vetëm 4.3 për qind e tyre kanë ushtruar të drejtën e votës në zgjedhjet e vitit 2014.

## Pjesëmarrja e votuesve të rinj në zgjedhjet e fundit parlamentare (2014)





## B. Motivet për të votuar

Kur të rinjtë përcaktohen se a do të votojnë në zgjedhje, motivet që ata marrin parasysh paraqesin ndër faktorët kryesorë që duhet analizuar me qëllim të rritjes së nivelit të pjesëmarrjes të tyre në zgjedhje. Të rinjtë që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim, janë deklaruar në lidhje me motivet që i shtyjnë ata të votojnë në zgjedhje. Ndërtimi i një të ardhme më të mirë për vendin, me 26.3 për qind, paraqet motivin kryesor të të rinjve për pjesëmarrje në zgjedhje. Të rinjtë që e shohin votimin si obligim dhe të drejtë të secilit, kanë renditur këto si motive për të votuar. 14.4 për qind e të të rinjve të intervistuar shohin votën si obligim dhe përgjegjësi qytetare, derisa 12.3 për qind si të drejtë që duhet t'a ushtrojë secili. Faktorët social

janë gjithashtu të rëndësishëm për motivimin e të rinjve. 9.7 për qind e respondentëve do të merrnin pjesë në zgjedhje, me motivin se të gjithë familjarët apo shoqëria e tyre kanë marrë pjesë në zgjedhje.

Ekziston dallim relativisht i ndjeshëm mes motiveve që kanë votuesit e komuniteteve të ndryshme në vend. Derisa shumica e të intervistuarve nga komuniteti shqiptar motiv parësor për të votuar në zgjedhje kanë ndërtimin e një të ardhme më të mirë për Kosovën (67.7 për qind), ky motiv zbehet tek komunitetet tjera jo-shumicë (43.8 për qind), dhe bie ndjeshëm tek komuniteti serb, të cilët kanë pothuajse **përgjysmë më pak** interes ndërtimin e një të ardhme më të mirë për vendin, në krahasim me të intervistuarit e komunitetit shqiptar.






## C. Motivet për të mos votuar

Ndonëse në përqindje, pjesëmarrja e të rinjve në zgjedhje ka qenë e kënaqshme përgjatë cikleve të kaluara zgjedhore, mbetet sërish një numër i konsiderueshëm i të rinjve që nuk votojnë, për arsye nga më të ndryshmet. Nëpërmjet këtij hulumtimi, janë evidentuar motivet kryesore se pse të rinjtë nuk marrin pjesë në zgjedhje, me fokus në zgjedhjet lokale. Motivi kryesor i mos pjesëmarrjes në zgjedhje, është bindja se një votë e vetme nuk bën ndryshim (22.2 për qind). Më tutje, faktor tjetër në motivimin e të rinjve për të mos votuar është edhe fakti që të rinjve nuk u pëlqejnë asnjë nga figurat apo partitë politike në

Kosovë (20.4 për qind). Anashkalimi i probleme të kanë rinia e vendit, dhe shtresëzimi i tyre me vite të tëra, ka ndikuar po ashtu në zbehjen e motiveve për të marrë pjesë në zgjedhje. 14.2 për qind e të rinjve kanë deklaruar që nuk do të marrin pjesë në zgjedhje pasi që për problemet që ata kanë, nuk është ofruar zgjidhje në asnjë program politik të partive politike.

Mungesa e interesimit për zgjedhjet në përgjithësi, manipulimet gjatë procesit zgjedhor, mosinformimi i qytetarëve lidhur me vendndodhjen dhe largësinë e qendrës së votimit, janë disa nga elementet tjera që shtojnë të rinjtë nuk marrin pjesë në zgjedhje.

### Motivet kryesore që i shtojnë të rinjtë të mos marrin pjesë në zgjedhje:





## D. Përmirësimi i procesit zgjedhor

Zgjedhjet e fundit parlamentare vlerësohen si transparente nga vetëm 16.4 për qind e të rinjve të intervistuar në këtë hulumtim. Ndër arsyet kryesore për këtë vlerësim të të rinjve, sipas tyre janë manipulimet me vota, rastet e dhunës, shkelja e rregullave zgjedhore, mungesa e mediave dhe në përgjithësi mungesa e sigurisë, sidomos në zonat rurale.

Me qëllim të **përmirësimit** të procesit zgjedhor dhe rritjes së integritetit të tij, të rinjtë kanë identifikuar disa nga veprimet

që duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse. Hapi i parë që duhet të ndërmerret, sipas të rinjve, është vetëdijësimi më i madh i votuesve mbi rëndësinë e votës (21.9 për qind), pasuar nga dënime më të larta për shkelësit e normave ligjore për zgjedhjet (21.3 për qind), pastrimi i listave zgjedhore (15.5 për qind), ndryshimin e përbërjes së KQZ-së, e cila duhet të udhëhiqet nga njerëz jo-partiak (15.3 për qind), përfshirja e sa më shumë të rinjve në procesin e administrimit të zgjedhjeve (10.8 për qind), përfshirja më e madhe e OJQ-ve në vëzhgim të zgjedhjeve (9.8 për qind) dhe fushatë informuese për procedurat e votimit (5.4 për qind).





# 5. SUBJEKTET POLITIKE DHE KANDIDATËT MË POPULLOR NË MESIN E VOTUESVE TË RINJ

## A. Subjektet politike më të preferuara

Sistemi shumë partiak të cilin e posedon Kosova, i ofron mundësi elektoratit që të ketë preferenca nga më të ndryshmet, në varësi të programit politik, kandidatëve, historikut apo veçorive tjera të një subjekti. Ky sistem, ofron gamë të gjerë të mundësive për të pasur preferenca për subjektet politike, nga grupe të ndryshme shoqërore. Të rinjtë e moshave 17 deri 21 vjeç, që janë fokus i këtij hulumtimi, kanë paraqitur preferencat e tyre politike, të cilat, megjithatë variojnë bazuar në gjininë, moshën, etninë, nivelin e edukimit, të ardhurat familjare dhe vendbanimin e tyre.


Kur këta të rinj janë pyetur se për kë do të votonin në rast të mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare, Lëvizja Vetëvendosje(LVV) është ranguar si subjekti i parë me 26.9 për qind, e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK) me 20.3 për qind, Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK) me 12.8 për qind, Aleanca Kosova e Re(AKR) me 7.1 për qind, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK) me 6.8 për qind, NISMA për Kosovën (NPK) me 2.7 për qind, Lista Serbe(LS) me 2.1 për qind, dhe partitë tjera me 2.9 për qind. Një përqindje domethënëse e të intervistuarve (18.4 për qind) kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje.

Këto preferenca të të rinjve reflektohen ngjashëm edhe për zgjedhjet e nivelit lokal. Lëvizja Vetëvendosje(LVV) mbetet subjekti më i preferuar edhe në nivelin lokal, me 23.9 për qind e të intervistuarve, ndjekur nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK) me 19.7 për qind, Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK) me 13.3 për qind, Aleanca Kosova e Re(AKR) me 8.9 për qind, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK) me 6.7 për qind, NISMA për Kosovën(NPK) me 2.7 për qind, Lista Serbe(LS) me 2.2 për qind dhe partitë tjera me 2.5 për qind. Për nivelin lokal, ka një rritje të lehtë të përqindjes së të rinjve që kanë refuzuar të përgjigjen(20 për qind), për dallim nga preferencat për zgjedhjet parlamentare.





## Shqetësimet e të rinjve të Kosovës





## B. 'Lojaliteti' ndaj subjektit politik

Element i rëndësishëm në përcaktimin e mënyrës se si të rinjtë votojnë është edhe ndikimi që kanë subjektet politike tek ky grup i elektoratit të tyre.

Rezultatet e nxjerra nga ky hulumtim, flasin për nivel relativisht të theksuar të **lojalitetit** dhe **disiplinës**<sup>2</sup> të të rinjve ndaj partisë për të cilën ata votojnë. Në këtë kontekst, rreth 35 për qind e të intervistuarve do ta dëgjonin partinë e tyre se për cilin kandidat të votohet në balotazh, në rast se kandidati i partisë në fjalë nuk ka arritur të jetë në balotazh. Bazuar në ndarjen sipas nivelit të edukimit, të rinjtë që kanë të përfunduar vetëm shkollimin fillor, konkretisht 55 për qind e tyre, kanë tendencë të jenë dukshëm më të disiplinuar ndaj partisë. Kurse, sipas ndarjes etnike, të rinjtë e komuniteteve tjera jo-shumicë janë më të disiplinuar (40.9 për qind), në krahasim me të rinjtë e komunitetit shqiptar (37 për qind), dhe atyre serb, të cilët del të jenë më së paku të lojal (25 për qind).

Të rinjtë kanë sjellje politike interesante edhe sa i përket votës 'kundër' një partie. 31.7 për qind e të rinjve të intervistuar kanë deklaruar që do të votonin një parti politike, **vetëm për t'ia pamundësuar fitoren një partie tjetër**, ndonëse kjo parti mund të mos përfaqësojë më së miri qëndrimet e tij apo saj.

Në pyetjen se a do të merrnin pjesë në zgjedhje, edhe nëse partia e preferuar e tyre nuk do të kishte fare kandidat në zgjedhjet lokale, 41.9 për qind e të rinjve janë përgjigjur pozitivisht, 32.2 për qind negativisht, ndërsa pjesa tjetër (25.9 për qind) janë deklaruar se nuk e dinë se si do të vepronin në këtë situatë.

## C. Politikanët model për të rinjtë

Në kuadër të këtij hulumtimi, me qëllim të evidentimit të politikanëve më popullor mes votuesve të rinj, të intervistuarve u është kërkuar që të japin një emër se kë e shohin ata si politikan model. Megjithatë, 23.5 për qind e tyre, kanë thënë se nuk kanë ndonjë politikan model. Nga pjesa e të intervistuarve që kanë dhënë një emër për politikanin model, del se politikanin model për votuesit e rinj është Albin Kurti me 13.7 për qind. Ai pasohet nga Hashim Thaçi me 10.5 për qind, Kadri Veseli me 7.4 për qind, Ramush Haradinaj me 5.4 për qind, Vjosa Osmani me 4.7 për qind dhe Shpend Ahmeti me 4.6 për qind. Të rinjtë e intervistuar kanë deklaruar edhe emrat e rreth 60 personaliteteve që tjera, mirëpo të cilët janë në përqindje më të vogël.

Për të intervistuarit e **komunitetit serb**, politikan model është Branimir Stojanoviç, kurse për të intervistuarit e **komuniteteve tjera jo-shumicë**, politikan model është Hashim Thaçi.


Ndër **atributet kryesore** që një politikan model duhet t'i ketë, sipas të rinjve të intervistuar, janë mbajtja e premtimeve të dhëna gjatë fushatës, niveli i lartë i integritetit profesional, dosja e pastër nga akuzat (sidomos për raste të korrupsionit), dhe personaliteti i respektuar nga të gjitha grupet shoqërore.

2 "Disiplina partiake" paraqet aftësinë e një subjekti politik për të ndikuar që përkrahësit e tyre të mbështesin politikën dhe vendimet e marra nga lidhshipi i subjektit në fjalë. Në shoqëritë demokratike, ky term i referohet kontrollit që liderët e nivelit qendror apo lokal, kanë ndaj militantëve të tyre.






## Politikani model për të rinjtë





# 31.7 %

e të rinjve të intervistuar kanë deklaruar që do të votonin një parti politike, vetëm për t'ia pamundësuar fitoren një partie tjetër, ndonëse kjo parti mund të mos përfaqësojë më së miri qëndrimet e tij apo saj.







"KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)



Projekti është mbështetur nga:



British Embassy  
Pristina